

## Raport Mujor për fondin Credins Premium

Fondi Credins Premium ka objektiv të maksimizojë të ardhurat tuaja, duke ruajtur principalin dhe likuiditetin. Portofoli i Fondit CREDINS PREMIUM, në përputhje me Politikën e Investimit, do të përbëhet kryesisht nga obligacione dhe bono të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Data e raportit: 30.11.2022

### Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	01 Korrik 2016
Monedha e Fondit:	Lek

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë:

- ✓ një normë kthimi më të lartë se produktet bankare,
- ✓ likuiditetin që i mungon këtyre produkteve.

### Profili i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët		Rrezik i lartë				
Përfitimet tipike më të ulëta		Përfitimet tipike më të larta				
1	2	3	4	5	6	7

Fondi CREDINS PREMIUM ka një profil rreziku në nivelin 2, pra të ulët.

### Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	1,033,133,920.71
Çmimi i kuotës	1,281.2335
Kohëzgjatja e Modifikuar	1.62 vjet
Kthimi nga investimi (30.11.2021 - 30.11.2022)*	-5.49 %

\* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

### Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond

#### Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e rëzimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i rëzimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

#### Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asete janë të emetuara nga Qeveria, agjencitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti ("rating") të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

\*Për më tepër informacion rreth rreziqeve të Fondit, ju lutem referojuni seksionit përkatës në Prospektin e Fondit Credins Premium.

### Kostot dhe Pagesat


Pagesat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të Fondit. Pagesat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

Tarifa e hyrjes apo daljes	0%
Tarifa e administrimit	1% në vit e VNA të Fondit
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	0 Lekë
Kosto të tjera:	
Kosto të transaksioneve për investimin e asetëve të fondit	sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese
Tarifa e auditimit vjetor të fondit	sipas kushteve të punës së kompanisë së auditit
Tarifa e depozitarit	0.1836% në vit e VNA
Tarifa e AMF	0.05% në vit e VNA

## Shpërndarja e Instrumenteve si përqindje e Aseteve Totale të Fondit

Shpërndarja e Instrumentave	ALL	%Aseteve
Obligacione	254,040,233.76	24.00%
Bono Thesari	157,952,962.84	14.92%
Të Arkëtueshme	6,948,954.22	0.66%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	639,385,762.81	60.41%


## Shpërndarja e Instrumenteve sipas Llojit



## Ankandet e titujve qeveritarë dhe normat e interesit


Qeveria e Republikës së Shqipërisë emeton letrat me vlerë në periudha relativisht të rregullta dhe të shpeshta. Në përputhje me materialet informuese të publikuara nga Ministria e Financave, ankandet për bonot e thesarit me afat 3-mujor dhe 6-mujor organizohen një herë në muaj, ndërsa ato 12-mujore organizohen çdo dy javë. Duke përfshirë ankandet e obligacioneve 2-vjeçare, të cilat zhvillohen një herë në muaj, ankandet e obligacioneve të tjera (3,5,7,10 dhe 15-vjeçare) zhvillohen me një frekuencë të përafërt prej 3 muajsh.

### Ecuria e yield-eve të Bonove 3, 6 dhe 12-mujore



Edhe gjatë muajit nëntor rezultatet e ankandëve të titujve rezultuan me rritje në të gjitha maturitetet. Rezultati i ankandit të datës 15 nëntor i bonos 3-mujore rezultoi me rritje nga 2.781% në 2.907%. Rezultati i bonos 6-mujore në datë 1 nëntor u rrit nga 3.834% në 4.572%, duke u rritur përsëri në 25 nëntor në 4.638%. Gjatë muajit nëntor u zhvilluan tre ankande për bono 12-mujore në datat 1 dhe 15 dhe 25 nëntor, të cilat rezultuan me rritje nga 5.264% në 5.743%, 5.83 dhe 5.8% (ulje e lehtë) përkatësisht.

### Ecuria e yield-eve të Obligacioneve



Gjatë muajit nëntor yield-i i obligacionit 2-vjeçar rihapje, rezultoi me rritje të lartë nga 4.9% në 6.48%. Ankandi i obligacionit referencë 5-vjeçar në datë 8 nëntor, rihapje, rezultoi me normë 7.687% nga 6.237% që ishte në shtator 2022. Ankandi i obligacionit 15-vjeçar, ri-hapje, në datë 22 nëntor, rezultoi me rritje nga 8.39% që ishte në shtator në 8.95%. Gjatë muajit nëntor nuk u zhvilluan ankande për obligacionet 3-vjeçar, 7-vjeçar dhe 10-vjeçar. Sa i përket ndryshimeve ditore të obligacioneve reference 3-5 vite, gjatë muajit nëntor trendi ka rezultuar rritës. Ndryshimet e yield-it nga 31 tetori në 30 nëntor janë si në vazhdim: për 3-vjeçarin nga 6.6% në 7%, për 4-vjeçarin nga 7% në 7.7% dhe për 5-vjeçarin nga 7.2% në 7.9%.

## Kthimi vjetor neto historik


Asetet e Fondit janë kryesisht të investuara në titujt e emtuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, dhe si rrjedhojë ecuria e normës së kthimit të Fondit ndikohet nga lëvizja e normave të interesit në ankandet e titujve të Qeverisë Shqiptare.

Fondi regjistron obligacionet dhe bonot në portofol sipas vlerës së drejtë, që do të thotë kryen vlerësimin e tyre të tregut çdo ditë. Çmimi i obligacioneve dhe i bonove ka një lidhje të zhdrejtë me normat e interesit. Kur normat e interesit në treg rriten, çmimi (vlera) e obligacioneve dhe bonove të mëparshme ulet dhe për rrjedhojë ulet dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen.

Kthimet neto të Fondit nga themelimi deri më 30 nëntor 2022 sipas periudhave të ndryshme janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Periudha e qëndrimit	Kthimi vjetor i periudhës
1 vjeçare	-5.49% në vit
2 vjeçare	-0.74% në vit
3 vjeçare	0.12% në vit
4 vjeçare	1.54% në vit
5 vjeçare	2.49% në vit
Që nga themelimi	3.40% në vit

### Norma neto vjetore historike e kthimit



Fondi ka filluar aktivitetin më **1 Korrik 2016**. Norma neto vjetore e 5 viteve të fundit përfaqëson normën e kthimit të portofolit pasi janë zbritur kostot dhe tarifat që i mbahen fondit. Të dhënat historike paraqiten për qëllime ilustrative dhe nuk duhet të konsiderohen si garanci për të ardhmen.


Në përgjigje të presionit të lartë inflacionist, Banka e Shqipërisë, ka rritur normën bazë pesë herë deri më 30.11.2022; në muajin Mars nga 0.5% në 1%, në 1.25% në muajin Korrik, në 1.75% në muajin Gusht, në 2.25% në muajin Tetor dhe 2.75% në muajin Nëntor. Rritja e inflacionit që po përjeton ekonomia shqiptare së bashku me rritjen e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë kanë sjellë një trend të ndjeshëm rritës të normave të interesit të titujve të qeverisë shqiptare për të gjitha maturitetet. Duke qenë se asetet e fondit përbëhen kryesisht nga këto tituj, trendi rritës ka pasur një impakt negativ të vazhdueshëm në normën e Fondit Credins Premium. Megjithatë, pritshmëritë janë që këto luhatshmëri të jenë brenda natyrës ciklike të fondit duke konsideruar horizontin e investimit. Masat që po ndërmerren nga Qeveria shqiptare për të mbajtur nën kontroll normat e borxhit të brendshëm, pritet të sjellin stabilitet të tregut financiar në vazhdim.

Përballë kësaj situatë, Shoqëria Administruese, ka ndërmarrë një proces ri-alokimi taktik të aseteve në instrumente afatshkurtër, për të ulur impaktet negative nga rezultatet e ankandeve. Ky proces është zhvilluar duke konsideruar gjithmonë interesin më të mirë të investitorëve dhe me efekt sa më të ulët për ta. Në vijim të këtij procesi ri-alokimi taktik të aseteve, Fondi është pozicionuar në më shumë se 50% të aseteve në instrumenta afatshkurtër dhe mjete monetare e ekuivalente të tyre.

Megjithë luhatshmërinë e lartë që kanë patur normat e titujve të borxhit të shtetit shqiptar gjatë vitit 2022, profili i riskut të Fondit Credins Premium mbetet në nivelin 2.

Duke konsideruar sa më lart, investitorët e Fondit inkurajohen të jenë të duruar, të mos bëjnë disinvestime të ndikuara nga kushtet e pafavorshme të tregut dhe të kenë një qasje të orientuar në vlerën afatgjatë të investimeve të tyre.

### Çmimi i Kuotës



*Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të fuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë [www.credinsinvest.com](http://www.credinsinvest.com).*